



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 05
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 14 nëntor 2017, në orën 13:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Faton Topalli, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Të ftuar: Shaban Osmanaj, kryetar i KQZ-së i Odës së Mjekëve, Rrezart Halili, nënkryetar i Odës së Mjekëve.

Pjesëmarrës të tjerë: Ervin Ibrahim – UNDP.

Stafi mbështetës i komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.11.2017;**
- 3. Sensibilizimi i komunitetit të mjekëve të Kosovës për zgjedhjet për Kuvendin e Odës së Mjekëve- Përkrahja institucionale për konsolidimin dhe funksionimin e Odës së Mjekëve të Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1.11.2017;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale miratoi, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 1.11.2017.

3. Sensibilizimi i komunitetit të mjekëve të Kosovës për zgjedhjet për Kuvendin e Odës së Mjekëve - Përkrahja institucionale për konsolidimin dhe funksionimin e Odës së Mjekëve të Kosovës

Kryetarja: Përshëndesim përfaqësuesin e Odës së Mjekëve, si dhe kryetarin e KQZ-së të Odës së Mjekëve, të cilët kanë kërkuar që të realizohet ky takim me komisionin, për të diskutuar rreth procesit zgjedhor për Kuvendin e Odës së Mjekëve, si dhe sensibilizimin apo përkrahjen në konsolidimin edhe funksionimin e odës. Pra, siç jeni në dijeni, ende s'janë bartur kompetencat tek Oda e Mjekëve, siç kërkohet me ligj, dhe në këtë rast, kemi pasur një mosfunksionim të mirë të odës. Sot do të diskutojmë për këtë çështje, sensibilizimin e mjekëve për të marrë pjesë në këtë proces zgjedhor. Pra, ju bëjmë thirrje të gjithë kolegëve tanë, mjekëve që kanë qëllim të mirë, të organizohen dhe të marrin pjesë në proces zgjedhore dhe t'i zgjedhin organet e tyre dhe të funksionalizojë sa më parë Odën e Mjekëve.

Rrezart Halili: Ju falënderojmë shumë për organizimin e këtij takimi, për të diskutuar rreth sensibilizimit të komunitetit të mjekëve të Kosovës për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvendin e Odës së Mjekëve. Më lejoni t'ju njoftoj se kryetarja e odës nuk ka mundur të marrë pjesë në këtë takim, për arsye se ka pasur një termin për vizë në Ambasadën amerikane. Gjatë këtij mandati, ne si odë kemi arritur që të jemi të gatshëm në aspektin legjislativ dhe besojmë se janë pjekur të gjitha kushtet për bartjen dhe funksionalizimin e Odës së Mjekëve, në aspektin legjislativ. Kurse, në aspektin teknik, si gjitha odat tjera, përballemi me disa sfida, të cilat besojmë se do të përmbushen me kohë. Organet e reja të odës, që do të dalin nga këto zgjedhje, do të kenë më të lehte në ushtrimin e kompetencave që ju takojnë me ligj. Ne, si odë, kemi marrë premtim nga ministri i MSH-së, që do t'i kemi kompetencat, të cilat na takojnë me ligjin e odave të profesionistëve shëndetësorë. Po ashtu, edhe ne shfrytëzojmë rastin që nga ky takim t'ju bëjë thirrje të gjithë kolegëve të mi që të konkurrojnë për Kuvendin e Odës, por edhe për kryetar të Odës së Mjekëve. Sa i përket përgatitjeve të zgjedhjeve për Kuvendin e Odës, ne kemi realizuar disa takime, si më ministrin dhe organizatën e Luksemburgut "Lux Devellopmen", ku na kanë ofruar mbështetjen për këtë proces.

Shaban Osmanaj: E falënderojë kryetaren dhe komisionin parlamentar për gatishmërinë tuaj për të na takuar dhe diskutuar rreth procesit zgjedhore të Odës së Mjekëve. Për herë të parë, po organizohen zgjedhjet nga vetë Oda e Mjekëve, me përkrahjen nga ministria dhe "Lux Devellopmen". Këto janë zgjedhjet e dyta, kurse zgjedhjet e para kanë qenë të organizuara nga MSH. Në kuvendin e mbajtur në fund të muajit gusht 2017, është vendosur që të themelohet KQZ për Odën e Mjekëve të Kosovës, kurse më datë 18.9.2017, është nxjerrë vendimi nga kryetarja e odës. Gjatë kësaj periudhe, janë marrë të gjitha veprimet përgatitore dhe janë nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme për KQZ-në e Odës së Mjekëve. Është hartuar lista e mjekëve, me të drejtë vote, në nivel të vendit. Në bazë të çelësit të formimit të njësive zgjedhore, janë

përcaktuar 74 njësi zgjedhore në vend. Në bazë të statutit, kemi edhe të deleguar sipas çelësit për njësi.

Bekim Haxhiu: Unë konsideroj se në këtë takim do të duhej të ishin përfaqësuesit e të gjitha odave të profesionistëve shëndetësorë. Pra, t'i dëgjojmë për sfidat që po ballafaqohen me funksionalizimin e odave. Kanë kaluar katër vite kur është miratuar Ligji për odat. Oda e Mjekëve do të duhej të ishte prijëse, sa i përket bartjes së kompetencave dhe përgjegjësi, mbrojtjen e interesit të pacientëve e në veçanti edhe të mjekëve si profesionistë shëndetësorë. Oda e Mjekëve ka ngecur, në raport me odat tjera. Ne, si komision, nuk duhet të interferojmë në këtë fazë që gjinden, pra në proces zgjedhor, sepse ky është proces i tyre i brendshëm. Ne, në vazhdimësi kemi shprehur shqetësimin për mosbartje të kompetencave, të cilat i konsiderojmë se qëllimisht nuk janë bartur tek odat nga ministria. Në këtë rast, është pamundësuar edhe funksionimi i odave. Ne ju ofrojmë mbështetje si komision, me theks të veçantë, bartjen e kompetencave nga ana e ministrisë, kurrsesi të mos ndërhyjmë në procesin zgjedhor. Shpreh shqetësimin se një pjesë e organeve vitale të odës nuk keni arritur t'u bëni siç është prokurori dhe gjykata e Odës së Mjekëve. Disa procese që po ndodhin, brenda institucioneve shëndetësore, do të duhej trajtoheshin fillimisht nga organet e odës, para se të shkojnë në prokurori. Nga KQZ kërkojmë të bëjë punën e vet, pa ndikime politike dhe të zhvillohet një proces demokratik, të zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Po ashtu, është mirë që të hyjë në program legjislativ Ligji për odat dhe të plotësohet, odat thuhet se janë të pavarura, mirëpo aspekti financiar tek çështja e edukimit të vazhdueshëm profesional.

Haxhi Avdyli: Projekti i odave ka qenë projekt ambicioz. Përkundër se ka kaluar një kohë e gjatë, ende nuk janë funksionalizuar. Unë konsideroj se nuk i ka përmbushur pritjet edhe të komunitetit të profesionistëve dhe ky është një dështim i politikë-bërjes për sektorin e shëndetësisë. Oda e Mjekëve është mbrapa të gjitha odave tjera, si rezultat i mosorganizimit të vetë mjekëve. Kemi ngecje si në bartjen e kompetencave, krijimin e strukturave në organizim të brendshëm, licencimin, kodin etik. Pyetje: Çka keni bërë si KQZ për sensibilizimin e mjekëve për pjesëmarrje në zgjedhje? Ne kemi informata se mjekët janë të zhgënjyer dhe s'janë aspak të interesuar që të marrin pjesë në këtë proces. Pyetje: A e keni rregulluar databazën e mjekëve në nivel vendi? Shpresojmë se do të marrin pjesë mjekët dhe do të zgjidhen njerëz vullnetmirë, më aktiv dhe do të jenë më kërkues në raport me bartjen e përgjegjësi tek odat. Ne jemi të njoftuar se oda ka ngecur edhe si rezultat i një kryetareje, e cila nuk ka pasur energji, entuziazëm për funksionalizim të saj. Dhe shqetësimi kryesor i tyre ka qenë mospagesa apo paga ndaj kryetares.

Fatmire Kollçaku-Mulhaxha: Sensibilizimi i mjekëve për të marrë pjesë në këtë proces është më se i domosdoshëm. Unë edhe pse jam mjekë, s'jam e informuar për këtë proces zgjedhor. Ky takim s'ka të bëjë me ndonjë interferim, por është sensibilizimi i mjekëve dhe ofrimi i mbështetjes në funksionalizimin e odës. Për ne, është shumë e rëndësishme që oda duhet t'i marrë kompetencat dhe t'i ushtrojë ato me përgjegjësi. Edhe ne inkurajojmë të gjithë profesionistët shëndetësorë apo mjekët, që të marrin pjesë në këtë proces dhe të dalin organe legjitime. Në këtë rast, oda është edhe si një lloj sindikate në mbështetjen dhe ruajtjen e profesionistëve shëndetësorë në profesionalizimin të tyre. Shpresojmë që në këtë proces të konkurrojnë njerëz të rinj dhe entuziastë, pra të jenë njerëz të duhur dhe të na përfaqësojnë si duhet. Ne ju ofrojmë mbështetje në këtë proces edhe në të ardhmen dhe do t'ju ndihmojmë në funksionalizim të odës, bartje të kompetencave nga ana e ministrisë.

Naser Rugova: Unë e konsideroj këtë takim që 5 minuta para orës 12, është i vonuar. Nga kontaktet që kemi me profesionistët shëndetësorë, shqetësimi kryesor është humbja e besimit tek

ky organizim. Pra, duhet të jetë preokupim i secilit. Ministria e Shëndetësisë duhet të bëjë bartjen e kompetencave tek oda, sa me parë dhe ta funksionalizojë. Pra, pa një bashkëpunim të hallkave ministri, odë profesioniste shëndetësore, nuk do të ketë normalizim të sistemit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve. Ministria është organi që merret me hartimin e politikave, kurse oda duhet t'i marrë kompetencat e veta, sipas ligjit. Edhe ne inkurajojmë mjekët që të marrin pjesë në këtë proces zgjedhor dhe të zgjedhin njerëz meritore që ia duan të mirën sistemit shëndetësor. Ne, si deputetë, do t'i mbështesim. Pra, do të llobojmë për odat, që të funksionalizohen dhe t'u barten kompetencat, sa më parë.

Flora Brovina: Ne kemi marrë pjesë në zgjedhjet e para, si mjeke dhe kemi parë interesimin shumë të madh të mjekëve, për të marrë pjesë. Tash, kemi zgjedhjet e dyta dhe s'po kemi interesim, duhet t'i ftojme mjekët, që të marrin pjesë, kjo është shqetësuese. Gjatë shqyrtimit të Ligjit për odat, kemi menduar se themelimi i odave do të jetë reformë në sistemin shëndetësor me shumë rendësi dhe do të kemi përmirësim të sistemit, por nuk ka ndodhur kjo gjë. Si komision, i kemi dhënë përkrahje edhe në mandatin e kaluar, mirëpo kanë qenë të paaftë në funksionalizim të Odës së Mjekëve, kurse odat tjera kanë avancuar më shumë se Oda e Mjekëve, kjo nuk do koment. Ne kemi pasur rast të takojmë edhe nga komuniteti serb, që të marrin pjesë në këtë organizim. Ne kemi përkrahur dhe zotohemi se do t'i përkrahim odat edhe në të ardhmen. Gjithashtu, kemi bërë presion edhe tek ministri për bartje sa më parë të kompetencave, mirëpo një gjë e tillë s'ka ndodhur, por këtu faji ka qenë edhe tek menaxhmenti i odave. Ne kemi reaguar edhe kur ka filluar procesi i licencimi të mjekëve nga ana e ministrisë, mirëpo s'ka qenë e përgatitur sa duhet, për të bartur këtë përgjegjësi. Shqetësuese ka qenë edhe baza materiale, mirëpo jo të kërkosh diçka pa e arsyetuar me punë angazhim. Edhe ne i ftojme mjekët që të marrin pjesë në proces zgjedhor dhe të zgjedhin njerëz meritore, që do të punojnë në të mirë të mjekëve dhe avancim të sistemit shëndetësor.

Besa Baftiu: Të gjithë kolegët shprehën shqetësimin e tyre se si ka rrjedhur, deri më tani, themelimi dhe funksionalizimi i odave. Po ashtu, bënë thirrje për pjesëmarrje në këtë proces, si dhe ofruan mbështetjen e tyre për funksionalizimin, bartjen e kompetencave tek odat nga ana e ministrisë. Siç u theksua, komisioni ka ftuar edhe ministrin e MSH-së, edhe përfaqësuesit e odave, që ky proces të përfundojë, ashtu siç është paraparë me ligj, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Sa i përket senzibilizimit të mjekëve, pyetje: a keni tentuar që edhe përmes RTK-së, si televizion publik, që t'i inkurajoni mjekët, që të marrin pjesë në procesin zgjedhor meqenëse është në interes publik? Theksuat se edhe me statut, anëtarët e Kuvendit të Odës mund të jenë të deleguar. Cilat njësi apo institucione kanë të drejtë për të deleguar?

Shaban Osmanaj: Humbja e besimit si dhe sensibilizimi i punës së përfaqësuesve të Odës së Mjekëve, kjo u konstatua nga ju, si deputetë. Arsyeja e kërkesës për takimit ishte sensibilizimi i të gjithëve për procesin zgjedhor. Ne, si KQZ, me forca tona vetjake i kemi bërë të gjitha këto përgatitje. Të gjitha mediat i kemi njoftuar që të marrin pjesë në konferencën për media, me rastin e shpalljes së zgjedhjeve, mirëpo fatkeqësisht s'kemi pasur pjesëmarrje të mediave, me përjashtim të një medie. Sa i përket databazës, që nga data 18 shtator 2017, jemi munduar që t'i mbledhim të gjitha të dhënat. Të dhënat e para i kemi marrë nga MSH, ku kemi probleme të mëdha, si çështja e specializimeve, pasi që kanë emërtime të ndryshme. Kemi mospërputhje të të dhënave të gjinia femërore, se diku kemi me emër të vajzërisë, diku me mbiemër të martesës. Aktualisht, numri i mjekëve është 2824, në tri nivelet e sistemit shëndetësor të mjekësisë familjare. Çelësi i zgjedhjes së anëtarëve për kandidat për nivelin primar, 50 mjekë për një njësi, delegohet një mjek, zgjidhet një mjek, në nivelin dytësor është 35 mjekë, kurse në nivelin terciar, 25 mjekë.

Enver Hoti: Me ligj iu takojnë një numër i madh i kompetencave. Cilat kompetenca keni hasur vështirësi në ushtrim të tyre? Dhe ndonjë arsye. A keni filluar që të krijoni të hyra me vetë-financim? Nëse po, a keni ndonjë raport financiar? Sipas ligjit, keni qenë të informuar se duhet të njoftoni ministrin e MSH-së. Sa i përket procesit zgjedhor, ne ju ofrojmë mbështetjen tonë, si komision dhe do të keni përkrahjen e vazhdueshme në funksionalizim të odave.

Rrezart Halili: Sa i përket vështirësive në implementimin e kompetencave, ju them se ne nuk na është bartur asnjë kompetencë, as raport financiar nuk kemi bërë, sepse nuk kemi pasur fare buxhet. Të gjitha që i kemi bërë, i kemi bërë me ndihmën e “Lux Developmen”. Zyrat na janë ndarë nga Ministria e Shëndetësisë, para një viti, dhe atë në kontejnerët te “Rilindja”. Edhe odat tjera, përveç Odës së Mjekëve, nuk kanë pasur shumë ecje përpara dhe nuk iu kanë bartur shumë kompetenca, sepse nuk ka pasur kushte.

Enver Hoti: Pasi nuk i keni marrë kompetencat, sipas ligjit, atëherë gjendja qenka e rëndë dhe ne duhet ta formojmë një grup, i cili do ta bëjë monitorimin e zbatimit të ligjit. Paska ngecje të mëdha dhe duhet t'i evidentojmë të gjitha problemet. Mendoj se këtu ka pasur edhe ndikime politike.

Flora Brovina: Komisioni i mandatit të kaluar e ka identifikuar se ku ndodhet problemi dhe problemi ka qenë te ministri i Shëndetësisë, i cili nuk i ka bartur kompetencat tek Oda e Mjekëve dhe nuk iu ka krijuar as kushte të punës. Pastaj edhe odat nuk kanë qenë shumë të afta ta ngrenë zërin dhe të kërkojnë të drejtat e tyre.

Enver Hoti: Këto problematika të odave dhe të shëndetësisë nuk janë diskutuar sa duhet në Kuvendin e Kosovës. Nuk është e mjaftueshme që, si deputetë, vetëm t'i evidentojmë problemet, por duhet të gjejmë edhe zgjidhje.

Fatmire Mulhaxha: A mund të na tregoni për përvojat tuaja që keni pasur nga vizitat në vendet tjera, cilat janë problemet me të cilat ballafaqohen odat në vendet tjera? Ne jemi shumë të interesuar të funksionalizohen odat dhe do t'ju ndihmojmë të barten kompetencat nga ministria tek odat.

Rrezart Halili: Ne kemi pasur pjesë të grupit punues për hartimin e ligjit, ekspertin slloven Brani Dobnika, dhe kur ai e ka parë ligjin e miratuar, është befasuar me ndryshimet që janë bërë në ligj. Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, me ligj, ka shumë ndikim tek odat, sepse ka të involvuar disa zyrtarë në punën e odave, ku në shtetet tjera kjo nuk ndodh. Pajtohem që koncepti i odave është bërë shumë ambicioz, pa u përgatitur për funksionalizimin e odave. Duhet pasur një bashkëpunim në mes odave dhe Ministrisë së Shëndetësisë, në aspektin e mbikëqyrjes, por jo të drejtën e delegimit të përfaqësuesve të ministrisë në Kuvendin e Odës, me të drejtë vote. Ligji thotë se Ministria e Shëndetësisë është kompetente për funksionalizimin e odave dhe krijimin e kushteve, por ministria nuk ka bërë asgjë.

Besa Baftiu: Nëse ka pasur vështirësi në zbatimin e ligjit, atëherë është dashur të kërkohej ndryshimi i Ligjit për odat. Në mandatin e kaluar kemi mbajtur disa takime dhe kemi bërë përpjekje që të funksionalizohen odat, por nga ajo që kemi vërejtur se ministri i mandatit të kaluar dhe kryetarja e odave kanë pasur disa probleme personale, që kanë ndikuar në funksionalizimin e odave. Këto çështje t'i mbeten të kaluarës, sepse tani jemi në një fazë tjetër që

të sensibilizohen të gjithë mjekët, që të marrin pjesë në garë dhe të zgjidhen organet e Odës së Mjekëve dhe të ecin proceset më tej.

Haxhi Avdyli: Një prej hapave të ardhshëm, pas konstituimit të organeve të reja të Odës së Mjekëve, do të duhet ta thërrasim ministrin e Shëndetësisë dhe t'i bëjmë një trysni pozitive dhe t'i bartë kompetencat tek odat. Po ashtu, çështje tjetër është se në Projektligjin e buxhetit, që ka ardhur, a është paraparë buxhet për funksionimin e odave deri në vetëfinancimin e tyre?

Rrezart Halili: Buxhet nuk kemi, vetëm na është premtuar që një përqindje e caktuar e mjeteve që janë grumbulluar nga rilicencimi do të na barten në xhirollogarinë e odave, por ende nuk ka asgjë në këtë drejtim.

Shaban Osmanaj: kemi kërkuar këtë takim që edhe përmes mediave t'i njoftojmë të gjithë për procesin që po ndodh, në zgjedhjet për organet e Odës së Mjekëve dhe ju falënderojmë për përkrahjen që po na jep, si Komision për Shëndetësi. Në fund të procesit zgjedhor, në pajtim me ligjin, do t'ju njoftojmë për gjithë procesin.

Fatmire Mulxha: Sa anëtarë të Kuvendit të odës vijnë si të deleguar?

Shaban Osmanaj: Nga 120 anëtarë të Kuvendit të Odës së Mjekëve, 20 janë të deleguar.

Besa Baftiu: Sa i përket mediave, mbledhjet e komisionit janë publike dhe mediat janë të pranishme sipas interesimit të tyre.
Ju faleminderit për informimin dhe për pjesëmarrjen tuaj!

4. Të ndryshme

Kryetarja: Në këtë pikë, përfaqësuesi i UNDP-së, z. Ervin Ibrahim, do na njoftojë me hapat që do të merren për miratimin e rezolutës për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ervin Ibrahim: Ju njoftoj se kam përgatitur disa dokumente për SDG, e që shumica e SDG lidhen me fushëveprimin e komisionit tuaj. Në SDG e tretë, flitet për shëndetin dhe mirëqenien, ku në këtë SDG, por edhe në SDG tjera, janë të parapara treguesit që duhet raportuar. Në treguesin e parë të kësaj SDG, thuhet se deri në vitin 2030 të ulet raporti i vdekshmërisë së fëmijëve në më pak se 70, për 100 000 mijë foshnje të lindura. Pritet që secili shtet, në nivel global, të raportojë për këta parametra, e edhe Kosova do të raportojë, edhe pse nuk është ende shtet anëtar i OKB-së. Pritet që dikush nga Kosova të raportojë për të gjitha SDG, e që janë gjithsej 17. Hapi i ardhshëm pritet që të jetë miratimi i rezolutës nga Kuvendi i Kosovës. Mendoj që procedimi i rezolutës do të bëhet nga komisioni juaj, pasi që shumica e SDG lidhen me komisionin tuaj. Unë kam përgatitur një draft të rezolutës dhe do t'ua përcjell. UNDP-ja mendon se ditët e miratimit të rezolutës në Kuvendin e Kosovës, të mbahet edhe një ceremoni solemne, ku mendohet të ftohet edhe kryetarja e IPU, edhe pse Kosova ende nuk është anëtare e IPU.

Naser Rugova: Mendoj se kryetarja e komisionit duhet të bashkëpunojë me kryetarët e komisioneve të tjera, që kanë kompetenca në disa nga SDG dhe rezoluta të përgatitet sa më mirë dhe të miratohet sa më shpejt.

Besa Baftiu: Pajtohem që ne të jemi bartës të rezolutës, pasi që shumica e SDG i takojnë komisionit tonë, por do të bashkëpunojmë edhe me komisionet tjera.

Flora Brovina: Të gjitha grupet parlamentare duhet që objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm t'i konsiderojnë si objektiva afatgjate dhe ta tejkalojnë edhe mandatin legjislativ. Vendimet për këtë çështje duhet të merren me konsensus. Ndoshta duhet të formohet edhe një nënkomision, për këtë çështje.

Fatmire Mulhaxha: E përkrah idenë që komisioni ynë të jetë bartës i rezolutës dhe i këtij procesi.

Kryetarja: Nga mbledhja e ardhshme do të fillojmë intensivisht të merremi me këtë rezolutë.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU